

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6375  
E premte, 30 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

## Mbi 70 raste të reja me Covid në Kosovë në 24 orët e fundit

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

"MINI-SHENGEN"-I EMERTOHEM "OPEN BALKAN" FAQE 4-5

# KOSOVA, MALI E ZI DHE BOSNJA NUK I BASHKOHEN NISMËS 'OPEN BALKAN'



Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia ia kanë ndërruar emrin iniciativës rajonale "Mini-Shengen", duke e pagëzuar "Open Balkan". Në Forumin Ekonomik për Bashkëpunim Rajonal, i cili është mbajtur në Shkup, kryeministri

Edi Rama, Zoran Zaev dhe presidenti Aleksandër Vuçiq i kanë ftuar edhe vendet e tjera të rajonit t'i bashkohen kësaj nismë për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe lëvizjes. Kjo nismë synon qarkullim pa ndalesa

në kufijtë në mes të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë. Në takimim e tre liderëve të rajonit nuk ka marrë pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili e ka kundërshtuar nismën e "Mini-Shengenit"


## Asetet e Trustit u rritën për 177 milionë euro në periudhën janar-qershor të këtij viti

FAQE 8



## Lamtumirë 'Mini-Shengen'!

Shkruan:  
Blerim REKA



FAQE 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht--Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## AKTUALE



**BEKIM JASHARI SHPALOS SLOGANIN E KANDIDATURËS "IDEAL PËR SKENDERAJN"** F.7

**SPECIALIZANTËT KËRKOJNË PAGESËN E KUJDESTARIVE DHE DITËVE FESTIVE** F.7

**HAPET URA E PELESHACIT QË LIDH DY BRIGJET E KROACISË** F.2



## EKONOMI



**ARKEP-i E QUAN PROBLEM TEKNIK SHFAQJEN E RRJETIT SERB NË DEÇAN** F.8

**PANDEMIA LA PA PUNË 10 PËR QIND TË GRAVE NË RAJONIN E PRISHTINËS** F.8

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Shkupi miraton rezolutën për “vijat e kuqe” me Sofjen

SHKUP, 29 KORRIK - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miratoi një rezolutë lidhur me kontestin me Bullgarinë, i cili ka bllokuar nisjen e bisedimeve të anëtarësimit midis Shkupit dhe Bashkimit Evropian.

Rezoluta e propozuar nga VMRO DPMNE-ja në opozitë i obligon institucionet që të mos negociojnë me palën bullgare lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me identitetin maqedonas, gjuhën dhe të kaluarën historike. Janë pikërisht këto çështje të cilat Sofja i konteston, pasi konsideron se gjuha maqedonase, sikurse edhe identiteti maqedonas, ekzistojnë pas vitit 1945, apo pas Luftës së Dytë Botërore. Para kësaj periudhe pala bullgare thotë se ato kanë pasur “rrënjë bullgare”. “Kërkojmë të respektohen studimet shkencore maqedonase në lidhje me autoktoninë e popullit maqedonas dhe vazhdimësinë historike, gjuhësore, kulturore. Të respektohen studimet shkencore, sipas të cilave, gjuha maqedonase dhe dialektet e saj kanë vazhdimësi hapësinore dhe

kohore. Të zbatohen konventat dhe deklaratat ndërkombëtare pozitive dhe përgjithësisht të pranuar nga Kombet e Bashkuara për të drejtën e vetëvendosjes si dhe të respektohet vullneti i shprehur lirisht dhe pa kushte për përkatësinë etnike të popullit maqedonas”, thuhet në rezolutën e miratuar nga 95 deputetët e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, përfshirë edhe deputetët e partisë në pushtet të kryeministrit Zoran Zaev.

Miratimi i rezolutës i kanë paraprirë përplasje të thella mes partive politike, meqë opozita maqedonase pretendon se pushteti po zhvillon negociatën të fshehta për lëshim për para kërkesave të palës bullgare - akuza këto që janë hedhur poshtë nga Lidhja Social-Demokrate në pushtet.

Miratimi i rezolutës mund ta ndërlikojë procesin e bisedimeve me Bullgarinë, pasi pa një marrëveshje Sofja nuk pritet të heqë dorë nga vetoja të cilën për herë të parë e ka përdorur në nëntor të vitit të kaluar, kur ka



pamundësuar fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE. Arritjen e një marrëveshjeje mes dy vendeve e pamundëson edhe kriza politike në Bullgari, ku edhe pas dy cikleve zgjedhore nuk ka një stabilitet politik për zgjedhjen e një qeverie që do të ishte në gjendje të merrte vendime

politike.

Një rezolutë për “vijat e kuqe” ka miratuar edhe Bullgaria, e cila, po ashtu, konfirmon përkushtimin për të mos hequr dorë nga kërkesat për Maqedoninë e Veriut, përkatësisht njohjen nga Shkupi të lidhshmërisë së gjuhës dhe identitetit maqedonas me Bullgarinë.

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje dy vendeve që të gjejnë një zgjidhje të pranueshme, që do ta zhblokonte nisjen e bisedimeve me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, pasi të dyja këto shtete vlerësohet se i kanë përmbushur kriteret për mbajtjen e konferencave të para ndërqeveritare.

## Hapet ura e Peleshacit që lidh dy brigjet e Kroacisë



ZAGREB, 29 KORRIK - Një urë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe e ndërtuar nga një kompani kineze ka lidhur dy brigje kroate të cilat janë të ndara nga një pjesë e vogël e territorit të Bosnje-Hercegovinës.

Korporata kineze për rrugë dhe ura ka fituar tenderin ndërkombëtar më 2018 për ta ndërtuar urën 2.4 kilometra të gjatë.

Ndërtimi i saj në vlerë të 420 milionë eurove është financuar 85 për qind nga Bashkimi Evropian.

Pas instalimit të segmentit të fundit, ceremonia e hapjes së urës

së Peleshacit është zhvilluar në mesnatën mes 28 dhe 29 korrikut. Kryeministri kroat Andrej Plenković ka thënë, gjatë ceremonisë së hapjes, se ura prezanton “një arritje strategjike fantastike të popullit dhe shtetit kroat”, e cila përmbush ëndrën që ka ekzistuar për kohë të gjatë, për t’i lidhur brigjet e Adriatikut.

Ura dhe rrugët lidhëse pritet të finalizohen në qershor të vitit të ardhshëm.

Deri atëherë udhëtarët që dëshirojnë t’i vizitojnë destinacionet më atraktive të

Kroacisë, siç është zona e Qytetit të Vjetër të Dubrovnikut, ende do të duhet të kalojnë dy pika kufitare në mes të Bosnjës dhe Kroacisë.

Zyrtarët e Bosnjës nuk kanë qenë të lumtur kur ka nisur ndërtimi i projektit, duke pretenduar se ura, që i shmanget territorit të Bosnjës, shkel të drejtën sovranë për qasje në ujërat në Adriatik.

Plenković ka thënë se ura nuk do të ndajë, por do të bashkojë njerëz dhe kombe. “Ura jo vetëm që lidh Kroacinë, por lidh edhe BE-në si dhe Bosnje-Hercegovinën”, ka thënë ai.

## Britania heq karantinën për të vaksinuarit nga ShBA-ja dhe BE-ja

LONDËR, 29 KORRIK - Udhëtarët e vaksinuar plotësisht nga Shtetet e Bashkuara dhe pjesa më e madhe e Evropës do të mund të hyjnë në Britani të Madhe pa iu nënshtruar masës së karantinës nga java e ardhshme, kanë thënë zyrtarët britanikë të mërkurën. Qeveria britanike ka thënë se personat që kanë pranuar dy doza të vaksinës së miratuar nga Administrata Amerikane për Ushqim dhe Ilaçe,

apo nga Agjencia Evropiane e Ilaçeve, do të mund të bëjnë teste për koronavirus para dhe pas hyrjes në Britani, në vend të izolimit për dhjetë ditë.

Qeveria e Skocisë, që vendos vetë për politikën shëndetësore, ka marrë vendimin e njëjtë. Irlanda Veriore, që është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar, nuk ka bërë me dije ndonjë vendim të ngjashëm. Aktualisht vetëm

personat që janë vaksinuar në Britani mund të mos i nënshtrohen masës së karantinës. Megjithatë, ekziston një përjashtim në vendim: Franca, të cilën Mbretëria e Bashkuar e konsideron me rrezik të lartë, për shkak të pranisë të variantit “Beta”.

Vizitorët nga Franca do të vazhdojnë të përballen me masë të karantinës.



# Gjermania do ta mbështesë Procesin e Berlinit dhe tregun e përbashkët

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim sekretarin e shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Miguel Berger. Ky i fundit i ka shprehur kryeministrit ngushëllime për aksidentin tragjik në Slavonski Brod të Kroacisë ku humbën jetën dhjetë bashkatdhetarë të cilët po udhëtonin nga Frankfurti për në Prishtinë.

Duke iu falënderuar, kryeministri Kurti i shprehu sekretarit Berger ngushëllime për jetët e humbura në disa pjesë të Gjermanisë si

pasojë e stuhisë dhe vërshimeve shkatërruese. Rëndësia e bashkëpunimit dhe rritja e investimeve gjermane në Kosovë ishte temë diskutimi, me theks të veçantë të mërgata e fuqishme në Gjermani.

Sekretari Berger e ka përgëzuar kryeministrin Kurti për indikatorët e mirë ekonomikë të vendit që, siç ka thënë ai, janë impresionues. Ai ka treguar se Gjermania do të mbështesë Procesin e Berlinit dhe tregun e përbashkët si formë e bashkëpunimit rajonal, dalë nga Samiti i Sofjes vitin e kaluar. Në këtë takim u diskutua edhe për takimet e fundit në Bruksel dhe

për ecurinë e mëtejshme dhe rëndësinë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim

sekretarin e shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Miguel Berger. Abdixhiku e ka njoftuar Bergerin për prioritetet e tij, qëndrimet e LDK-së karshi situatës aktuale politike si dhe për organizimin e LDK-së për zgjedhjet lokale të tetorit. Ai e ka falënderuar Bergerin për mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman i ka dhënë Kosovës në të gjitha proceset. Gjatë takimit u diskutua për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, për nevojën për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës si dhe për procesin e Berlinit, i cili, ndër të tjera, parasheh edhe liri të lëvizjes për qytetarët e Ballkanit Perëndimor.



## Mbi 70 raste të reja me Covid në Kosovë në 24 orët e fundit



PRISHTINË, 29 KORRIK - Në Kosovë u konfirmuan të enjten edhe 72 raste të reja me Covid-19. Këto raste kanë rezultuar pas testimit të 2 443 mostrave, ka bërë me dije Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, duke u thirrur në të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Në 24 orët e kaluara u

shëruan 17 pacientë, ndërsa raste aktive me koronavirus mbeten 305, thuhet në njoftim.

Në Kosovë, që nga fillimi i pandemisë në pranverën e vitit të kaluar, janë konfirmuar gjithsej 108 203 raste me koronavirus. Prej këtyre, 2 265 pacientë kanë vdekur dhe 105 633 janë

shëruar.

Deri të enjten në Kosovë janë dhënë 400 217 vaksina kundër koronavirusit, 12 123 vetëm në 24 orët e fundit. Mbi 130 000 qytetarë janë të vaksinuar plotësisht.

Qeveria e Kosovës ka thënë se e ka prioritet vaksinimin e 60 për qind të qytetarëve deri në fund të vitit.

## Policia kufitare konfiskon 86 palë pantallona në pikën kufitare Jarinjë

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Njësisia Policore e Hetimeve dhe Inteligjencës e Drejtorisë Rajonale Veriu të Policisë Kufitare, gjatë zbatimit të planit operativ "Befasia", të enjten në pikën kufitare Jarinjë ka dërguar në vijë

të dytë të kontrollit një autobus të relacionit Novi Pazar - Prishtinë. Gjatë kontrollit më të hollësishëm, në një hapësirë të fshehur në bagazhin e autobusit është gjetur mall i kontrabanduar, 86 palë pantallona. Për rastin

është njoftuar prokurori i cili ka autorizuar inicimin e rastit "kontrabanda e mallrave". I dyshuari me mallin e kontrabanduar është dorëzuar në terminalin doganor për procedim të mëtejshëm.





“MINI-SHENGEN”-I EMERTOHET “OPEN BALKAN”

# Kosova, Mali e Zi dhe Bosnja nuk i bashkohen nismës ‘Open Balkan’

Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia ia kanë ndërruar emrin iniciativës rajonale “Mini-Shengen”, duke e pagëzuar “Open Balkan”. Në Forumin Ekonomik për Bashkëpunim Rajonal, i cili është mbajtur në Shkup, kryeministri Edi Rama, Zoran Zaev dhe presidenti Aleksandër Vuçiq i kanë ftuar edhe vendet e tjera të rajonit t’i bashkohen kësaj nisme për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe lëvizjes. Kjo nismë synon qarkullim pa ndalesa në kufijtë në mes të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë. Në takimin e tre liderëve të rajonit nuk ka marrë pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili e ka kundërshtuar nismën e “Mini-Shengenit”

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ai i Shqipërisë Edi Rama dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u kanë bërë thirrje edhe vendeve të tjera të rajonit që t’i bashkohen nismës “Mini-Shengenit” e cila të enjten është emërtuar në “Open Balkan”. Në kuadër të Forumit Ekonomik për Bashkëpunim Rajonal në Shkup, të tre liderët kanë vlerësuar se kjo nismë është mundësia e

vetme për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe lëvizjes së lirë. Kjo nismë synon qarkullim pa ndalesa në kufijtë në mes të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë. Në takimin e tre liderëve të rajonit nuk ka marrë pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili në vazhdimësi ka kundërshtuar nismën e “Mini-Shengenit”. Zaev, Rama dhe Vuçiq në kuadër të forumit nënshkruan dy memorandume dhe një marrëveshje ndërshtetërore që ka për qëllim lehtësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave me qëllim të

forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik. Marrëveshja parasheh ndërtimin e “korsive të shpejta” në pikat kufitare për kalimin më të shpejtë të njerëzve nga shtetet e rajonit. Ajo përmban edhe dispozita për sa i përket thjeshtësimit të formaliteteve për importin, eksportin dhe lëvizjen, përkatësisht transportimin e mallrave; bashkëpunimin mes doganave dhe autoriteteve të tjera kompetente; si dhe dispozita të veçanta për sigurinë e ushqimit, çështjet veterinarë dhe fitosanitare dhe

lëvizjen e lirë të produkteve industriale joushqimore.

Marrëveshja e bashkëpunimit për mbrojtje dhe shpëtim nga katastrofat në Ballkanin Perëndimor dhe Memorandumi i mirëkuptimit për lehtësimin e importit, eksportit dhe lëvizjes së mallrave në Ballkanin Perëndimor dalin nga nisma për bashkëpunim të avancuar ekonomik rajonal në të mes Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Serbisë. Dokumentet paraqesin funksionalizimin e iniciativës për t’i përmirësuar kushtet në lidhje me shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe iniciativën për bashkëpunim mes vendeve në drejtim të mbrojtjes dhe shpëtimit nga katastrofat.

**Rama: Çështja e të shkuarës zgjidhet nëse shikojmë nga e ardhmja**

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalimin e tij në këtë formë, u ka bërë thirrje edhe vendeve të tjera të rajonit që t’i

bashkohen kësaj iniciative. Ai ka theksuar se çështjet e të shkuarës zgjidhen shumë më lehtë nëse sytë janë nga e ardhmja. “Ne jemi këtu për të ardhmen. Çështjet e të shkuarës zgjidhen shumë më lehtë nëse sytë janë nga e ardhmja. Me sytë nga e shkuara nuk ka çështje të së shkuarës si zgjidhje drejt të së ardhmes. Të gjitha këto vende duhet të jenë pjesë e këtij procesi. Unë nuk e kuptoj Malin e Zi për çka mendohet. Mendohet se si ta zgjidhë problemin me krahun e punës, duke qëndruar i mbyllur ndaj kësaj nisme, që është një problem serioz për të gjitha vendet, por që në Mal të Zi është bërë një problem shumë i madh. Po Bosnja për çfarë mendohet? Sepse e di për çfarë mendohet Kosova dhe në këtë pikë jam absolutisht me një qëndrim të kundërt, sepse për mua të gjitha këto vende duhet të jenë pjesë e këtij procesi dhe duhet të bëjnë maksimumin në këtë proces për veten e tyre, për njerëzit e tyre, për shoqëritë e tyre dhe për të gjithë së bashku”, ka deklaruar

# Kosova kundër takimit Rama, Zaev dhe Vuçiq

Qeveria e Kosovës ka bërë me dije se nuk ka pasur ftesë për pjesëmarrje në takimin e tre liderëve të rajonit. Qeveria ka vlerësuar se kjo iniciativë nuk ka vizion. "Iniciativa e Novi Sadit nuk e ka miratimin tonë dhe, si rrjedhojë, nuk kemi pasur zyrtarisht ftesë për pjesëmarrje në takim. Për ne, i ashtuquajtur 'Mini-Shengen' është nismë pa vizion për rajonin. Ne kemi propozuar avancimin e bashkëpunimit rajonal nga CEFTA në SEFTA sipas modelit të EFTA-EEA, nga e cila do të përfitonin njëkohësisht të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor", është thënë në përgjigjen e Zyrës së Kryeministrit për "Radion Evropa e Lirë".

Ndaj takimit Rama, Zaev, Vuçiq ka reaguar Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe

Lirive të Njeriut (KMDLNj). Në reagimin për media të këtij këshilli është thënë se duhet të ketë bashkëpunim rajonal, por fillimisht duhet të sqarohet e kaluara me viktimat e krimeve serbe. "Republika e Kosovës nuk ka interes të mbyllet hermetikisht dhe nuk e bën këtë por, krahasuar me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ka pësuar shumë në luftën e fundit, prandaj e ka të pamundur ta tejkalojë këtë çështje pa u sqaruar e kaluara e që Serbia me kokëfortësi dhe arrogancë po refuzon të ballafaqohet me të kaluarën e saj kriminale, nuk dëshiron ta pranojë përgjegjësinë dhe fajësinë shumë konkrete për krimet e kryera në Kosovë: krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, deri në

gjenocid", ka vlerësuar këshilli, duke shtuar se Serbia fillimisht duhet të kërkojë falje për krimet e luftës. "Serbia po e zbaton në praktikë ndjenjën e pandëshkueshmërisë për kriminelët e saj dhe po projektin dhe prodhon 'kriminelë' në radhët e shqiptarëve (viktimize) duke mos e pranuar as aktin fillestar simbolik siç është kërkim-falja e që është vetëm hap i parë drejt normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. Për më keq, në mënyrë flagrante po ndërhyjnë në punët e brendshme të një shteti sovran dhe të pavarur duke bërë përpjekje për destabilizim afatgjatë të Kosovës përmes instrumentalizimit të pakicës serbe në Kosovë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Rama. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka theksuar se bashkëpunimi është mundësia e vetme për zhvillimin e rajonit. Në fjalimin e tij, ai ka theksuar se në këtë iniciativë nuk pretendohet që njëri shtet apo shteti tjetër do të fitojnë më shumë. "Ajo që ne po bëjmë ka për qëllim të tregojmë se të kaluarën mund ta lëmë pas nesh, të shohim drejt së ardhmes, para së gjithash në ngritjen e standardit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve tanë. Nga 1 janari i vitit 2023 ne më nuk do të kemi kufij në vendet tona. Gjithsesi kalimet kufitare do të ekzistojnë, por nuk do të ekzistojnë për qytetarët tanë. Thjesht, nga Beogradi do të niseni deri në Tiranë dhe askush s'do t'ju ndalë dhe e kundërta. Askush s'do të pyesë asgjë dhe s'do t'ju ndalë dhe me këtë e rritim edhe sigurinë e qytetarëve tanë", ka theksuar Vuçiq, Apel për t'iu bashkuar nismës ka

bërë edhe kryeministri maqedonas Zoran Zaev. "Ne edhe një herë i ftojmë edhe inkurajomë edhe kolegët e tjerë që të na bashkohen për shkak të popujve tanë. Të gjithë ne jemi Ballkan, të gjithë jemi Ballkani evropian", ka deklaruar Zaev, duke shtuar se bashkëpunimi ekonomik dhe lëvizja e lirë e njerëzve dhe e mallrave është mundësia e vetme që ky rajon të ketë të ardhme. "Dua t'ju bind se vullneti politik i presidentit Vuçiq, i kryeministrit Rama dhe i imi është shprehje e përkushtimit tonë maksimal për sigurimin e të gjitha kushteve që varen nga qeveritë e tri vendeve tona, për bashkëpunim rajonal efikas dhe efektiv. Ky është një vullnet i fuqishëm dhe vendosmëri për të mirën e popujve tanë për lidhjen dhe zhvillimin e ekonomive tona, për ndërtimin e një ekonomie të përbashkët, për zhvillimin e rajonit, për jetë më të mirë të

çdonjërit prej nesh. Po lidhemi ekonomikisht që popujt tanë një orë e më parë të ndiejnë përfitimet ekonomike nga lehtësimet që po i bëjmë. Presim që kjo shumë shpejt të reflektohet në buxhetet tona dhe në jetën e standardin e miliona njerëzve që jetojnë në këtë pjesë të rajonit", ka deklaruar Zaev. Forumi i Shkupit për Bashkëpunim Rajonal në Ballkanin Perëndimor, i organizuar nga Dhomat e Tregtisë të Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Serbisë, ka mbledhur shumë se 300 kompani nga këto tri vende, si dhe ekonomi të tjera rajonale dhe evropiane, por edhe përfaqësues të qeverive, institucioneve financiare, universiteteve, delegacioneve dhe shoqatave ndërkombëtare. Shumica e kompanive janë nga sektori i ndërtimitarisë, agro-shqimit, energjisë, makinerisë, industrisë së automobilave,

# Lamtumirë "Mini-Shengen"



Shkruan: Blerim REKA

1. Sot në Shkup "troika" e Novi Sadit varrosi "Mini-Shengenin Ballkanik" dhe inauguroi trilateralin. Vuçiqi dështoi, plotë tre vjet, që ta shesë reinkarnimin e Jugosllavisë në ambalazhin e integritit rajonal. Shengeni i vogël ishte fasadë e Jugosllavisë së madhe. Tri shtetet e tjera ballkanike e refuzuan atë. Tjetër epilog edhe nuk mund të pritej, pa pajtimin e të gjitha gjashtë shteteve të rajonit. Serbia, ndërkaq, këmbëngulte për "integrim rajonal", por pa e njohur Kosovën. Beneluksi, si integrimi i parë modern rajonal evropian që i parapriu BE-së, funksionoi vetëm si lidhje e tri shteteve të njohura reciprocisht (Belgjikë, Holandë, Luksemburg). Si mund të funksiononte ky "integrim" i Vuçiqit, kur dy shtete ende nuk e njohin Kosovën?

2. Ky është dështimi i katërt i hegjemonisë "rajonale" të Beogradit brenda një shekulli. I pari, ai i krijimit të Jugosllavisë - pa jugosllavë, (por me sundimin serb) dështoi

përkundër hyrjes së kroatëve dhe slovenëve në mbretëri me mbretin serb. Pas dështimit të asaj Jugosllavie të parë monarkike (1941) dhe të dytës komuniste (1991), dështoi edhe e treta serbo-malazeze (2006).

3. Nga viti 2019 Beogradi u përpoq ta shesë idenë për "Jugosllavinë evropiane", me një emër tjetër: "Mini-Shengen Ballkanik", ama sërish nën hegjemoninë tregtare, ushtarake e politike serbe. Ndryshimi i emrit nuk ndryshoi përmbajtjen. Atëherë si shtet i sllavëve të jugut, sot si "integrim rajonal" me Shqipërinë plus. Por, as Mali i Zi, (konstituenti i fundit i Jugosllavisë së fundit), madje as Bosnja e Hercegovina (me Republika Srpsken brenda) nuk u joshën nga oferta e Beogradit. Ndërkaq, Kosova e refuzoi kategorikisht jo vetëm pse nuk ishte ftuar si shtet sovran dhe i pavarur, por edhe nga rreziku i zëvendësimit të anëtarësimit në BE, me "integrim rajonal" nën tutellën serbe.

4. Si mund të funksiononte një lidhje e tillë shtetesh, me orientime të kundërta gjeostrategjike? Me një Serbi anti-NATO dhe aleate ruse; me tri shtete anëtare të NATO-s dhe të katërtin me NATO-n brenda? Me pesë shtete që nuk kanë alternativë pos integritit euroatlantik e me Serbinë që në vend të Unionit Evropian, hyri në Unionin Euro-Aziatik të Putinit?

tekstilit, turizmit, programimit, telekomunikacionit, transportit e fushave të tjera. Në kuadër të forumit janë mbajtur edhe takime të shumta të biznesmenëve nga rajoni ku janë shkëmbyer pikëpamje për thellimin e

bashkëpunimit ekonomik. Ideja e "Mini-Shengenit" ballkanik është paraqitur në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019, nga liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.



## Bekim Jashari shpalos sloganin e kandidaturës “Ideal për Skenderaj”

SKENDERAJ, 29 KORRIK (ER) - Kryetari aktual i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, në një ceremoni madhështore ka zyrtarizuar kandidaturën e tij edhe për një mandat. Ai ka bërë zyrtarizimin e kandidaturës së tij në një ceremoni ku një numër enorm

i qytetarëve i janë përgjigjur ftesës së tij.

Kryetari Jashari në adresimin e tij para qytetarëve ka premtuar se do t'i vazhdojë punët e mira për komunën e Skenderajt. “Derisa dje ideal kishim çlirim të vendit të cilin e arritëm me mund dhe

sakrificë, sot ideal i secilit prej nesh është zhvillimi ekonomik i shtetit të cilën do ta arrijmë me dije e përkushtim maksimal në shërbim të vendit. Andaj sot po fillojmë rrugëtimin e përbashkët rreth sloganit ‘Ideal për Skenderaj’, ka theksuar Jashari.



## Nënshkruhet projekti i ri katërvjeçar mes AKK-së dhe GIZ-ORF

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e projektit katërvjeçar në mes të AKK-së dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH përmes programit “Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Jug-Lindore” - Energji, Transport dhe Mbrojtje Klimatike (ORF-ETC), në emër të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Komunat e Kosovës do të jenë përfituese të këtij projekti dhe që rezultatet kryesore që synohen të arrihen gjatë zbatimit të këtij projekti janë: 1. Komunat e Kosovës do të zhvillojnë plane të qëndrueshme të energjisë dhe klimës, SECAP. Pika fillestare e veprimit është iniciativa “Besëlidhja e Kryetarëve të Komunave në Evropë e njohur si Covenant of Mayors” me seli në

Bruksel, Belgjikë. Duke iu bashkuar nismës, komunat do të angazhohen të kontribuojnë në qëllimet e BE-së për mbrojtjen e klimës dhe të zhvillojnë një SECAP.2. Do të zbatohen projekte në shkallë të vogël të përzgjedhur nga SECAP-et përkatëse. Projekti siguron mundësinë për ta mbështetur zbatimin e projekteve në shkallë të vogël në komunat përmes një procesi konkurrues të organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës. 3. Komunat janë të autorizuar të marrin pjesë në një qeverisje në shumë nivele për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të energjisë dhe klimës. Dhe 4. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërrajonal midis nismave të “Besëlidhjes së kryetarëve të komunave në Evropë” dhe komunave të energjisë dhe klimës mbështet arrijtjen e qëllimeve të “Besëlidhjes së kryetarëve të komunave në Evropë”.



## Haziri: Në kushte pandemie kemi arritur rezultate inkurajuese në këtë gjashtëmuor



GJILAN, 29 KORRIK (ER) - Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur të enjten seancë, në të cilën ka shqyrtuar raportin e kryetarit të komunës për gjashtëmuorin e parë të këtij viti.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ndonëse është punuar në kushtet e pandemisë, megjithatë janë arritur rezultate inkurajuese dhe, siç ka thënë, e gëzon fakti që qytetarët u janë përgjigjur mirë obligimeve të tyre, veçmas tatimit në pronë. “Fatmirësisht, në këtë periudhë kemi rënie drastike të të infektuarve dhe në këtë çast që po flasim janë vetëm 25 raste aktive me Covid-19, por ajo që neve na ka shqetësuar dhe prekur

thellësisht është humbja e 147 bashkëqytetarëve tanë”, ka thënë Haziri, duke shtuar se lajm i mirë është se në qershor kemi filluar vaksinim masiv dhe deri më tani janë imunizuar 17 mijë persona që, sipas ekspertëve, është e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur nga Covid-19.

Haziri ka folur për të hyrat nga tatimi në pronë, që në këtë periudhë shënojnë një rekord të bardhë prej 240-përqindësh, ku përfshihet edhe pagesa nga viti i kaluar - 1.1 milion euro dhe i ka falënderuar qytetarët për lojalitetin e treguar për kryerjen e obligimeve ndaj shtetit, të cilët gjithmonë kanë qenë shembulli më i mirë në nivel vendi.

## Nënshkruhet marrëveshja për restaurimin e Sahat Kullës

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Të enjten u nënshkrua marrëveshja për bashkëfinancimin e restaurimit të Sahat Kullës me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP Sahat Kulla, si një prej

monumenteve me të shquara të trashëgimisë kulturore në Prishtinë, shumë shpejt pritet të rifunksionalizohet duke rikthyer kujtimet e së kaluarës sonë të përbashkët.

Projekti po realizohet me propozimin e studentëve të

Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin “Hasan Prishtina”, nën mentorimin e profesoreshës Florina Jërliu dhe asistentit të saj Rron Beqiri dhe do të implementohet bashkë me organizatën CHWB.



## Pandemia la pa punë 10 për qind të grave në rajonin e Prishtinës



PRISHTINË, 29 KORRIK - Në Prishtinë gratë u goditën nga pandemia, duke lënë 10 për qind të tyre të papuna për gjashtë muaj deri në një vit, krahasuar me burrat që ka qenë shifra prej 4-përqindësh. Theksi vendoset në mungesë të sigurisë dhe shëndetit në punë, ku një numër

i madh rrezikohen në hapësirat e punës. Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) ka lansuar të enjten raportin "Perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në rajonin e Prishtinës", ku janë anketuar 200 gra dhe burra në rajonin e Prishtinës, me qëllim

që të informohen vendimmarrësit dhe qeveritë mbi politikat kryesore sociale dhe të mirëqenies. Mrika Sefaj nga IKS ka theksuar se ushqimet dhe furnizimet shtëpiake zënë midis 10 deri në 80 për qind të kostove familjare. Të ardhurat mesatare të familjes

të shpenzuara për këtë kategori shpenzimesh janë 45,5 për qind që është e konsiderueshme. Ajo ka pohuar se më shumë se shumica e grave dhe të rinjve pëlqejnë të punësohen jashtë vendit. "Gratë dhe të rinjtë prej 72-përqindësh preferojnë të punësohen jashtë vendit në

krahasim me burrat që kanë interesim më të ulët prej 42-përqindësh", ka thënë Sefaj. Drejtoresha e IKS-së, Brikenë Hoxha, ka theksuar se janë të përkushtuar për të drejtat e grave dhe se po punojnë që politikave publike t'u ofrojnë të dhëna empirike.

## Andin Hoti thotë se do të angazhohet për fatin e personave të zhdukur në Kosovë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryesuesi i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Andin Hoti, i cili e drejton edhe delegacionin e Grupit Punues për Persona të Zhdukur, ka takuar përfaqësuesit e shoqatave të familjarëve për persona të zhdukur në Kosovë. "Si

kryesues, por edhe si familjar, jam zotuar për bashkëpunim të ngushtë me familjarë dhe me shoqata, për të siguruar dhe trajtuar informacionet e mundshme për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur", ka thënë Hoti.

Ai ka treguar se komisioni së bashku me institucionet e tjera të linjës aktualisht po punon në disa

lokacione të mundshme brenda territorit të Kosovës. "I sigurova se familjarët dhe shoqatat që i përfaqësojnë ata, në komunat përkatëse, do të jenë të informuar rregullisht për ecurinë. Po ashtu, i njoftova se jemi në pritje të raporteve të ADN-së për gërmimin e varrezës masive në Kizhevak dhe sapo t'i kemi këto raporte do të njoftohen me

rezultatet", është shprehur Hoti. Ai ka theksuar se Ligji për Persona të Zhdukur është në plotësim-ndryshim nga Ministria e Drejtësisë dhe, sipas tij, janë të vendosur që, krahas këtij plotësimi, të përmblidhen edhe kërkesat e familjarëve të personave të zhdukur me dhunë. "Në të gjitha takimet kemi bashkëbiseduar edhe për çështje

të tjera që lidhen me funksionimin e komisionit dhe që kërkojnë bashkëpunimin e familjarëve të shoqatave për të zhdukurit. Jam shumë i nderuar dhe i vlerësoj pa masë urimet e mirëpritjen e zgjedhjes time si kryesues. Besoj që së bashku të arrijmë sadopak ta shërojmë këtë plagë të shumë familjeve e të mbarë Kosovës", ka thënë Hoti.

## Specializantët kërkojnë pagesën e kujdestarive dhe ditëve festive

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Specializantët e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë protestuar të enjten për shkak të mospagesës së kujdestarive të fundjavës dhe të ditëve të festave. Mospagesën e të njëjtave specializantët e kanë quajtur diskriminues dhe

nënçmim të punës së tyre. Në rast se nuk do të merret vendim që të paguhen për mbajtjen e kujdestarive, specializantët kanë paralajmëruar se do t'i sabotojnë kujdestaritë dhe do t'i ndjekin edhe rrugët ligjore për ta realizuar këtë të drejtë. Përfaqësuesi i Këshillit të

Specializantëve, Arianit Zajmi, njëherësh specializant në Neurologji, ka thënë se mospagesa për mbajtjen e kujdestarisë është një ofendim për ta. E në rast se nuk do të merret vendimi që të njëjtat të paguhen, Zajmi ka theksuar se do të bojkotojnë kujdestaritë gjatë fundjavës.



# ARKEP-i e quan problem teknik shfaqjen e rrjetit serb në Deçan

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 29 KORRIK** - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, udhëhequr nga Jeta Statovci, nënkryetare e parë e komisionit, ka vizituar Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Arsyja e vizitës së komisionit ishte informuese lidhur me dukurinë e shfaqur me dërgimin sms-ve si pasojë e roamingut me MTS doo dërguar qytetarëve në lokacionin e Manastirit të Deçanit. Deputetët u pritën nga kryetari i

bordit të ARKEP-it, Nazim Rahimi, me bashkëpunëtorë, të cilët iu përgjigjën shqetësimeve të tyre, duke i njoftuar ata hollësisht lidhur me ngjarjen dukurinë në fjalë.

Përfaqësuesit e ARKEP-it sqaruan se, sipas informatave që ka marrë nga operatorët, kjo dukuri ka ndodhur si pasojë e vendosjes së marrëveshjes së re për roaming ndërkombëtar në mes të operatorit IPKO dhe Telekomit të Serbisë. Siç duket, në këtë lokacion (zona e Deçanit) si pasojë e një lëshimi teknik nga Telekom Serbia dhe humbjes së sinjalit nga rrjeti amë i

konsumatorëve të IPKO-s, konsumatorët e IPKO-s janë lokalizuar në roaming. Po ashtu, ARKEP-i ka sqaruar se mesazhet në fjalë nuk i ka dërguar MTS, mirëpo janë mesazhe që u dërgon IPKO konsumatorëve të vet kur ata lokalizohen në roaming në një shtet të huaj.

ARKEP-i, pas marrjes së informatës, menjëherë ka kontaktuar operatorin IPKO dhe MTS doo, me ç'rast është informuar se problemi është zgjidhur dhe se kjo dukuri nuk duhet të përsëritet.

Përfaqësuesit e ARKEP-it kanë konfirmuar se ka bërë verifikime

dhe testime në disa lokacione dhe kanë konstatuar se ky problem është eliminuar. ARKEP-i vazhdon ta trajtojë këtë çështje duke analizuar hollësitë në mënyrë që dukuri të tilla të mos përsëriten në territorin e Republikës së Kosovës.

Komisioni u njoftua se ARKEP-i ka marrë informata më të hollëshme rreth marrëveshjes së IPKO-s me Telekom Serbia dhe është duke analizuar përmbajtjen e marrëveshjes në përputhje të detyrave të ARKEP-it. Po ashtu, deputetët u interesuan edhe lidhur me obligimet që ka operatori MTS doo në zbatim të

marrëveshjes së Brukselit. Lidhur me këtë çështje deputetët u informuan se ky operator funksionon në bazë të marrëveshjes së Brukselit me autorizim të përkohshëm për operim me infrastrukturë dhe kapacitete të kufizuara. ARKEP sqaron se në vazhdimësi është duke e monitoruar operatorin MTS doo dhe për pikat të cilat nuk ka përmbushur, sipas marrëveshjes së Brukselit, është sanksionuar nga ARKEP konform rregullativës në fuqi.

Pjesë e delegacionit ishin edhe deputetët Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni dhe Pal Lekaj.



## Asetet e Trustit u rritën për 177 milionë euro në periudhën janar-qershor të këtij viti

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 29 KORRIK** - Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka njoftuar se ka arritur paraqitje të kënaqshme në gjysmën e parë të këtij viti. Trusti ka njoftuar se kthimi bruto nga investimet përgjatë muajve janar-qershor 2021 arriti në plus 108 milionë euro, kurse asetet e fondit u rritën për 177 milionë euro dhe arritën në 2.17 miliardë euro. "Kjo performancë pozitive erdhi nga vlerësimi i tregjeve financiare dhe nga


vendimmarrja e FKPK-së në alokimin taktik përgjatë kësaj periudhe. Këtë vit institucioni ka drejtuar investime në instrumente të reja financiare për t'i dhënë edhe më shumë diversitet, rrjedhimisht shpërndarje riskut investues, por edhe synuar kthim sa më të lartë", është thënë në njoftimin për media të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Njëkohësisht është bërë me dije se investimet në Kosovë kanë vazhduar në letrat me vlerë të qeverisë dhe depozitat bankare, që në fund të gjashtëmujorit

ishin rreth 568 milionë euro. "Sikurse është deklaruar edhe më parë, bordi vazhdimisht synon rritjen e investimeve brenda vendit. Me këtë rezultat FKPK-ja ka akumuluar prej themelimit rreth 660 milionë euro kthim bruto nga investimet", ka njoftuar FKPK-ja. Po ashtu, është theksuar se gjatë këtij gjashtëmujori u përmbyll me sukses edhe procesi i tërheqjes së 10-përqindshit përmes të cilit 427 363 kontribuues i tërhoqën mbi 198 milionë euro, me fitim mesatar prej 24.2-përqindësh.







GOTTLOB FREGE

# MBI KONCEPTIN DHE OBJEKTIN

(*Vjschr. f. wissensch. Philosophie 16, 1892, f. 192-205*)

[192] Benno Kerry në një seri artikujsh mbi intuitën dhe përpunimin e saj psikik në këtë të tremuajshme shpesh në mënyrë konfirmuese, pjesërisht kundërshtuese, i referohet librit tim *Bazat e aritmetikës* dhe shkrimeve të mia të tjera. Kjo vetëm mund të më gëzojë dhe mendoj se mund të tregohem mirënjohës në mënyrën më të mirë nëse marr pjesërisht diskutimin e pikave që ka kontestuar ai. Kjo më duket se është aq më e nevojshme sepse kundërshtimi i tij pjesërisht qëndron gjithsesi në një keqkuptim, të cilin mund ta ndajë me të tjerët për atë që kam thënë mbi konceptin [*Begriff*], dhe për arsye se kjo çështje është mjaft e rëndësishme dhe e vështirë kështu që edhe pa këtë arsye të veçantë do të duhej të trajtohej më thellë sesa më dukej që është e përshtatshme në veprën time *Bazat e aritmetikës*.

Fjala "koncept" përdoret në mënyra të ndryshme, pjesërisht në kuptim psikologjik, pjesërisht në kuptim logjik, e pjesërisht ndoshta në një përzjerje të paqartë të të dyjave. Kur një herë ekziston kjo liri e tillë, atëherë kufirin e saj natyror e gjen në kërkesën që t'i përmbahemi mënyrës një herë të miratuar të përdorimit. Unë kam vendosur që t'i përmbahem rreptësisht përdorimit të pastër logjik. Pyetjen se a është më i përshtatshëm ky apo ai përdorim, dua ta lë mënjanë si pyetje më pak

të rëndësishme. Do të merremi vesh lehtësisht për mënyrën e shprehjes, kur të jetë pranuar se fjala është për diçka që meriton emërtim të veçantë.

Më duket se keqkuptimi i Kerry-t është shkaktuar nga fakti se ai pa dashje e përzien mënyrën e vet të përdorimit të fjalës "koncept" me përdorimin tim. Nga kjo dalin lehtë kontradikta, për të cilat nuk duhet fajësuar mënyra ime e përdorimit.

[193] Kerry konteston atë që ai e quan definicionin timin të konceptit. Këtu do të doja, para së gjithash, të vë në pah se shpjegimi im nuk është menduar si definicion i mirëfilltë. Nuk mund të kërkohet që çdo gjë të definohet, sikur që as nga një kimist s'mund të kërkojmë që t'i zbërthejë të gjitha substancat. Ajo që është e thjeshtë nuk mund të zbërthehet, kurse ajo që është logjikisht e thjeshtë nuk mund të ketë definicionin të mirëfilltë. Ajo që është logjikisht e thjeshtë nuk është e dhënë paraprakisht, po aq pak sa shumica e elementeve kimike, por fitohet vetëm me anë të punës shkencore. Nëse gjejmë diçka që është e thjeshtë ose që, të paktën, për momentin duhet të vlejë si e thjeshtë, për këtë qëllim do të jetë e nevojshme të formësohet një emërtim, pasi që gjuha nuk do të ketë në mënyrë origjinale shprehje saktësisht të përshtatshme. Nuk është i mundur definicioni për futjen në përdorim të një emri për atë që është logjikisht e thjeshtë. Prandaj, nuk mbetet asgjë tjetër,

përveçta udhëzime lexuesin ose dëgjuetin me shenja që me fjalë të kuptojë atë se çfarë është nënkuptuar.

Kerry nuk do të lejojë që dallimi midis konceptit dhe objektit të vlejë në mënyrë absolute. Ai thotë: "Në një vend më herët e kemi shprehur pikëpamjen se marrëdhënia në mes të përmbajtjes së konceptit [*Begriffsinhalt*] dhe objektit të konceptit [*Begriffsgegenstand*] në njëfarë aspekti është marrëdhënie e veçantë, e pareduktueshme; por me këtë nuk ishte e lidhur pikëpamja se vetitë 'të qenët koncept' dhe 'të qenët objekt' përjashtojnë njëra-tjetrën; mendimi i fundit rrjedh nga i pari, po aq pak sikur të themi që nga ajo që marrëdhënia midis babait dhe birin nuk është e reduktueshme, rrjedh se dikush s'do të kishte mundur të jetë në të njëjtën kohë baba dhe bir (edhe pse natyrisht jo, p. sh., babai i atij, biri i të cilit është vetë)".

Le të lidhemi me këtë shëmbëlltyrë! Sikur të ekzistonte ose nëse kanë ekzistuar qenie të tilla, të cilat edhe pse janë etër, por të mos mund të ishin bij, atëherë padyshim se qeniet e tilla do të ishin qenie krejt të ndryshme nga të gjithë njerëzit që janë bij. E njëjta gjë është edhe këtu. Koncepti - ashtu si e kuptoj unë këtë fjalë - është predikativ<sup>1</sup>. Përkundër kësaj, emri i objektit [*Gegenstandsname*], emri i

përveçem [*Eigenname*] nuk mund të përdoret aspak si predikat gramatikor. Në mënyrë që të mos duket gabimisht, kjo natyrisht ka nevojë për sqarim. A nuk mund të themi njëjtë për diçka se ky është Aleksandri i Madh ose se ky është numri katër ose se ky është planeti Venera, sikur që mund të themi për diçka se kjo është e gjelbër ose [194] se ky është gjitar? Nëse mendojmë kështu, ne nuk po dallojmë mes mënyrave të përdorimit të fjalës "është". Në dy shembujt e fundit ajo shërben si këputje, vetëm si fjalë që formon pohimin [*als bloßes Formwort der Aussage*]. Si e tillë, ajo herë pas here mund të përfaqësohet nga prapashtesa thjesht vetore. Të krahasojmë, p. sh., "kjo fletë është e gjelbër" dhe "kjo fletë gjelbëron". Atëherë themi se diçka bie nën koncept dhe se predikati gramatikor me atë rast qëndron për [*bedeutet*] këtë koncept. Në të kundërtën e kësaj, në tre shembujt e parë, fjala "është" është përdorur siç përdoret në aritmetikë shenja e barazisë, për të shprehur një ekuacion.<sup>2</sup> Në fjalinë "Ylli i mëngjesit është Venera" kemi dy emra të përveçem, "Ylli i mëngjesit" dhe "Venera" për të njëjtin objekt. Në fjalinë "Ylli i mëngjesit është planet" kemi një emër të përveçem - "Ylli i mëngjesit" - dhe një fjalë për koncept [*Begriffswort*] - "planet". Vërtet, gjuhësisht nuk ndodh asgjë, përveç që "Venera" u zëvendësua me "planet"; mirëpo, objektivisht

raporti është bërë raport krejt tjetër. Ekuacioni është reversibil; rënia e objektit nën koncept është raport ireversibil. Fjala "është" në fjalinë "Ylli i mëngjesit është Venera", siç duket, nuk është vetëm këputje, por edhe përmbajtësisht është pjesë thelbësore e predikatit, kështu që në fjalët "Venera" nuk është përfshirë tërë predikati.<sup>3</sup> Në vend të kësaj mund të thuhej: "Ylli i mëngjesit nuk është asgjë tjetër përveç Venera" dhe atë që më parë ishte në fjalën "është" në kuptimin e thjeshtë të saj, këtu e kemi ndarë në pesë fjalë, kurse në "nuk është asgjë tjetër përveç" fjala "është" është me të vërtetë ende vetëm këputje. Ajo që thuhet këtu, pra, nuk është Venera, por asgjë tjetër përveç Venera. Ato fjalë qëndrojnë për konceptin, nën të cilin vërtet bie vetëm një objekt i vetëm; por koncepti i tillë prapëseprapë duhet dalluar ende nga objekti.<sup>4</sup> Këtu kemi fjalën "Venera", e cila, në fakt, nuk mund të jetë kurrë predikat [195] edhe pse mund të formojë një pjesë të predikatit. Referenca<sup>5</sup> [*Bedeutung*] e kësaj fjale, pra, nuk mund të paraqitet kurrë si koncept, por vetëm si objekt. Faktin se ekziston diçka e tillë nuk do të kishte dashur ta kontestojë as Kerry. Por, me këtë do të lejohej dallimi, pranimi i të cilit është shumë i rëndësishëm, në mes të asaj që mund të paraqitet vetëm si objekt dhe çdo gjëje tjetër. E ky dallim nuk do të fshihej as atëherë nëse do të ishte e vërtetë ajo që

mendon *Kerry*, se ekzistojnë koncepte që mund të jenë edhe objekte. Vërtet ka raste të cilat duket se mbështesin këtë pikëpamje. Unë vetë kam vënë në pah këtë (*Bazat* § 53, në fund) se koncepti mund të bjerë nën një koncept më të lartë, por kjo nuk duhet ngatërruar me subordinimin e një koncepti nën një koncept tjetër. *Kerry* nuk apelon në këtë, por jep një shembull: “Koncepti ‘kalë’ është koncept i kapshëm lehtë” dhe mendon se koncepti ‘kalë’ është objekt, dhe pikërisht një prej objekteve që bien nën konceptin ‘koncept i kapshëm lehtë’. Krejt e saktë! Dy fjalët, koncepti ‘kalë’ emërtojnë një objekt, por pikërisht për këtë arsye jo ndonjë koncept, ashtu si e përdor unë këtë fjalë. Kjo përputhet në mënyrë të përkryer me kriterin<sup>6</sup> që kam dhënë, sipas të cilit, nyja e shquar te njëjisi tregon gjithmonë ndonjë objekt, kurse nyja e pashquar shoqëron ndonjë fjalë për koncept [*Begriffswort*]. *Kerry* tani vërtet mendon se nuk mund të bazojmë asnjë rregull logjike mbi dallimet gjuhësore, por mënyra si e bëj unë këtë, është diçka që s’mund ta shmang askush që bën rregulla të tilla, sepse nuk mund ta kuptojmë njëri-tjetrin pa gjuhë dhe për këtë arsye në fund gjithmonë varem nga besimi se tjetri i kupton fjalët, format dhe formimin e fjalisë në thelb ashtu sikur edhe ne vetë. Siç u tha tashmë, s’dua të jap definicion, por vetëm të lë të kuptohet me shenja, duke u thirrur me atë rast në ndjenjat e përgjithshme të gjuhës gjermane. Këtu mund të jetë për mua mjaft i dobishëm fakti se dallimi gjuhësor ndeshet shumë mirë me dallimin real. Te nyja e pashquar nuk mund të vërehet fare ndonjë përjashtim nga rregulla jonë, përveç formulave të lashta si “ein edler Rat” [“një këshilltar fisnik”]. Puna nuk është aq e thjeshtë [196] te nyja e shquar, sidomos në shumës; por kriteri im nuk ka lidhje me këtë rast. Për sa shoh unë, te njëjisi puna është e dyshimtë vetëm atëherë kur ai qëndron në vend të shumësis, si në fjalitë “Turku e rrethoi Vjenën [der Türke belagerte Wien]”, “kali është kafshë katërkëmbëshe [das Pferd ist ein vierbeiniges Tier]”. Këto raste janë aq lehtë për t’u kuptuar si diçka e veçantë, sa që paraqitja e tyre vështirë se e dëmton vlerën e rregullës sonë. Është e qartë se në fjalinë e parë “Turku” është emër i përveçëm i një populli. Fjalja e dytë, ndoshta, mund të konsiderohet në mënyrë më të përshtatshme si shprehje e një gjykimi të përgjithshëm, si “të gjithë kuajt janë kafshë katërkëmbëshe” ose “të gjithë kuajt e formuar mirë janë kafshë katërkëmbëshe”, për çka do të flitet më vonë.<sup>7</sup> Kur *Kerry* e quan të papërshtatshëm kriterin tim, duke pohuar se në fjalinë “koncepti, për të cilin po flas tani, është koncept individual” emri që përbëhet nga shtatë fjalët e para emërton sigurisht një koncept, ai nuk e kupton fjalën “koncept” në kuptimin tim, e kontradikta nuk qëndron në postulatet e mia. Mirëpo, askush nuk mund të


kërkojë që mënyra ime e të shprehurit duhet të përputhet me atë të *Kerry*-t.

Duhet pranuar se kur themi [197] se koncepti *kalë* nuk është koncept<sup>8</sup> ndërsa, p. sh., qyteti Berlin është, megjithatë, qytet, e vullkani Vezuv është, megjithatë, vullkan, këtu sigurisht ekziston një ngathtësi e pashmangshme gjuhësore. Gjuha këtu gjendet në një telash, i cili justifikon devijimin nga e zakonshmja. Se rasti ynë është rast i veçantë, *Kerry* këtë e sugjeron vetë me anë të thonjzave te fjala “kalë”. Për të njëjtin qëllim unë përdor kursivin. S’ekzistonte asnjë arsye për të theksuar në mënyrë të ngjashme fjalët “Berlin” dhe “Vezuv”. Në hulumtimet logjike jo rrallë është ndier nevoja që të thuhet diçka për konceptin dhe që edhe ajo të vishet në formën e zakonshme për pohimet e tilla, që pikërisht pohimi të bëhet përmbajtje e predikatit gramatikor. Prandaj, si referencë e subjektit gramatikor do të pritej të ishte koncepti, por ai nuk mund të paraqitet ashtu për arsye të natyrës së tij predikative, por së pari duhet të shndërrohet në objekt ose, thënë më saktë, duhet të përfaqësohet nga një objekt<sup>9</sup> të cilin e emërtojmë me ndihmën e fjalës “koncepti”, të cilën e vendosim përpara, p. sh., “koncepti *njeri* nuk është i zbrazët”.

Dy fjalët e para këtu duhen kuptuar si emër i përveçëm<sup>10</sup>, i cili nuk mund të përdoret në mënyrë predikative, po aq pak sa edhe “Berlini” apo “Vezuvi”. Nëse themi: “Jezusi bie nën konceptin *njeri*”, atëherë predikati (nëse nuk e marrim parasysht këputjen) është që bie nën konceptin *njeri* e kjo do të thotë [bedeutet] të njëjtin gjë si “njeri”. Por, sintagma koncepti “*njeri*” është vetëm pjesë e atij predikati.

Pavarësisht prej natyrës predikative të konceptit, mund të argumentohet se, megjithatë, bëhet fjalë për konceptin e subjektit. Por, edhe në raste të tilla si, p. sh., në fjalinë “të gjithë gitarët kanë gjakun të kuq” nuk mund të mos pranohet natyra<sup>11</sup> predikative e konceptit; sepse në vend të kësaj mund të thuhet: [198] “Ajo që është gitar, ka gjakun të kuq” ose “nëse diçka është gitar, atëherë ajo ka gjakun të kuq”.

Kur e shkrova veprën *Bazat e aritmetikës* nuk pata bërë ende dallimin midis kuptimit dhe referencës<sup>12</sup> dhe për këtë arsye në shprehjen “përmbajtje e gjykueshme” [*beurteilbarer Inhalt*] kam përmbledhur atë që tani duke e dalluar e emërtoj me fjalët “mendim” [*Gedanke*] dhe “vlerë e vërtetësisë” [*Wahrheitswert*]. Për këtë arsye tani nuk e miratoj më krejt tekstualisht shpjegimin që kam dhënë atje në faqen 77, edhe pse në thelb ende mendoj njëjtë. Duke kuptuar “predikatin” dhe “subjektin” në kuptimin gjuhësor, mund të themi shkurt se: Koncepti është referenca e predikatit, e objekt është ajo që nuk mund të jetë kurrë referenca e plotë e predikatit, por mund të jetë gjithsesi referencë e një subjekti. Duhet të theksohet se fjalët “të



gjithë”, “çdo”, “asnjë”, “disa” qëndrojnë para fjalëve për koncepte [*Begriffswörtern*]. Në fjalitë e përgjithshme dhe partikulare afirmative dhe negative i shprehim raportet mes koncepteve dhe me ato fjalë lëmë të kuptojmë mënyrën e caktuar të këtij raporti; ato, pra, s’duhet të lidhen logjikisht më afër me fjalën për koncept e që vjen pas tyre, por duhet të shtrihen në tërë fjalinë. Kjo shihet lehtë te mohimi. Nëse në fjalinë “të gjithë gitarët janë banorë tokësorë” sintagma “të gjithë gitarët” do ta shprehte subjektin logjik të predikatit *janë banorë tokësorë*, atëherë për ta mohuar tërësinë, duhet mohuar predikatin: “Nuk janë banorë tokësorë”. Në vend të kësaj, “nuk” duhet vendosur para “të gjithë”, nga e cila rrjedh se “të gjithë” logjikisht i takon predikatit. Përkundrazi, fjalinë “koncepti *gitar* është i nënrenditur konceptit *banor tokësor*” e mohojmë duke e mohuar predikatin “nuk është i nënrenditur konceptit *banor tokësor*”.

Nëse i përmbahemi mënyrës time të të folurit, se shprehjet si “koncepti *F*” nuk emërtojnë koncepte, por objekte, atëherë [199] pjesa më e madhe e kundërshtimeve të *Kerry*-t bie poshtë. *Kerry* gabon kur mendon (f. 281) se unë e identifikoj konceptin [*Begriff*] dhe vëllimin e konceptit [*Begriffsumfang*]. Unë vetëm kam shprehur mendimin tim se në shprehjen “numri që i përket konceptit *F* është vëllimi i konceptit *numerikisht i barabartë me konceptin F*”. Fjalët “vëllim i konceptit” mund të zëvendësohen me fjalët “koncept”. Këtu shihet mirë se fjala “koncept” pastaj është e lidhur me nyjën e shquar. Veç kësaj, kjo ishte vetëm një vërejtje rastësore mbi të cilën s’kam


themeluar asgjë.

Prandaj, përderisa *Kerry*-t nuk i shkon për dore ta kapërcejë humnerën mes konceptit dhe objektit, deklaratat e mia mund të interpretoheshin ashtu. Kam thënë<sup>13</sup> se dhënia e një numri përmban pohim për një koncept; unë flas për vetitë që i jepen konceptit dhe lejoj që koncepti të bie nën koncept më të lartë<sup>14</sup>. Ekzistencën e kam quajtur veti të konceptit. Një shembull do ta tregojë më së miri si e mendoj këtë. Në fjalinë “ekziston të paktën një rrënjë katrore e 4” nuk thuhet diçka në lidhje me numrin e veçantë 2, as për -2, por për konceptin, pikërisht për *rrënjën katrore të 4*, thuhet se ky nuk është i zbrazët. Por, nëse të njëjtin mendim e shpreh në këtë mënyrë: “koncepti *rrënjë katrore e 4* është i plotë”, atëherë pesë fjalët e para formojnë emrin e përveçëm të një objekti dhe për këtë objekt pohohet diçka. Por, shihet lehtë se ky pohim nuk është i njëjti si ai për konceptin. Kjo është e habitshme vetëm për dikë që nuk arrin të kuptojë se mendimi mund të zërthehet shumëfish dhe që në këtë mënyrë si subjekt dhe si predikat paraqitet herë kjo e herë ajo. Mendimi vetëm nuk përcakton se çfarë duhet kuptuar si subjekt. Nëse themi: “Subjekti i këtij gjykimi”, atëherë emërtojmë diçka të veçantë vetëm në rast kur në të njëjtin kohë tregojmë për një lloj të veçantë të zbrërthimit. Këtë e bëjmë në të shumtën e rasteve në lidhje me një formulim të caktuar. Por, ne nuk duhet të harrojmë kurrë se fjali të ndryshme mund ta shprehin të njëjtin mendim. Kështu në mendimin tonë do të mund ta gjenim edhe një pohim për numrin 4: “Numri 4 ka vetinë që ekziston diçka, katrori i të cilës është ai”.

[200] Gjuha ka mjete që

mundësojnë që si subjekt të paraqitet herë kjo e herë ajo pjesë e mendimit. Një nga mjetet më të njohura është dallimi i trajtave aktive dhe pasive. Prandaj, nuk është e pamundur që i njëjti mendim te *një* zbrërthim të duket si mendim singular, te një tjetër si mendim partikular e të një zbrërthim i tretë si mendim i përgjithshëm. Prandaj, nuk është e habitshme që e njëjta fjali mund të interpretohet si pohim për një koncept dhe, gjithashtu, si pohim për një objekt; vetëm se duhet të merret parasysht fakti se këto pohime janë të ndryshme. Në fjalinë “ekziston të paktën një rrënjë katrore e 4” fjalët “një rrënjë katrore e 4” nuk është e mundur t’i zëvendësojmë me fjalët “koncepti *rrënjë katrore e 4*”: dmth. pohimi që i përshtatet konceptit, nuk i përshtatet objektit. Edhe pse fjalja jonë nuk e lë që koncepti të duket si subjekt ajo, megjithatë, pohon diçka për të. Kjo mund të kuptohet edhe në atë mënyrë sikur të shprehej rënia e një koncepti nën një koncept më të lartë.<sup>15</sup> Por, në këtë mënyrë nuk fshihet asesi dallimi në mes të objektit dhe konceptit. Së pari, vërejmë se në fjalinë “ka të paktën një rrënjë katrore të 4” konceptit nuk i mohohet natyra e tij predikative. Mund të themi “ekziston diçka që ka vetinë që e shumëzuar me veten jep 4”. Si për pasojë, s’mund të thuhet kurrë për objektin kjo që po thuhet këtu për konceptin, sepse emri i përveçëm s’mund të jetë kurrë shprehje për predikat, edhe pse ai mund të jetë pjesë e një shprehjeje të tillë. Nuk dua të them se është e gabuar të thuhet për objektin ajo që thuhet këtu për konceptin, por dua të them se është e pamundur, se është e pakuptimtë. Fjalja “është Jul Çezari [es gibt Julius Cäsar]” nuk është as e vërtetë, as e pavërtetë, por e pakuptimtë, edhe pse fjalja “Është një burrë [es gibt einen Mann] me emrin Jul Çezari” ka kuptim, por këtu kemi përsëri një koncept, siç mund ta shohim përmes nyjës së pashquar. Të njëjtin gjë e kemi në fjalinë “është vetëm një [es gibt nur ein] Vjenë”. Nuk duhet të na mashtrorë fakti se gjuha nganjëherë të njëjtin fjalë e përdor herë si emër të përveçëm e herë si fjalë për koncept. Numërori këtu lë të kuptojmë se fjala është për këtë të fundit. “Vjenë” këtu është fjalë për koncept njësoj sikurse “metropol”. Në këtë kuptim mund të thuhet “Triesta nuk është Vjenë [Triest ist kein Wien]”. Nëse [201], përkundër kësaj, në fjalinë “koncepti *rrënjë katrore e 4* është i plotë”, emrin e përveçëm të formuar nga pesë fjalët e para e zëvendësojmë me “Jul Çezari”, atëherë na rezulton një fjali që ka kuptim por që, megjithatë, është e pavërtetë; sepse plotësia, ashtu si kuptohet kjo fjalë këtu, mund të thuhet në të vërtetë vetëm për objektet e llojit krejt të veçantë, domethënë për të tillët që mund të emërtohen me anë të emrave të përveçëm të formës “koncepti *F*”. Por, fjalët “koncepti *rrënjë katrore e 4*” në lidhje me zëvendësueshmërinë e vet sillen esencialisht ndryshe nga fjalët “rrënjë katrore e 4” në fjalinë





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Driton Kuka: Medaljet e arta së shpejti zbarkojnë në trojet shqiptare

Trajneri Driton Kuka ka thënë se dy medaljet e arta së shpejti zbarkojnë në trojet shqiptare. "Medaljet olimpike për popullin shqiptar së shpejti do zbarkojnë në trojet shqiptare. Xhudistët e ekipit tonë i përfunduan garat në Lojëra Olimpikë! Dy medalje të arta! Ende po më duket si ëndërr e mirë. Pesë garues e dy të arta. Medaljet janë të krejt ekipit me protagonistë Disin e Norën. Ashtu siç ishte e arta e Majlindës", ka thënë Kuka



## "Epoka e re"

**PRISHTINË, 29 KORRIK** - Xhudistja Loriana Kuka e ka përfunduar pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", pasi pësoi humbje në raundin e dytë nga xhudistja ruse Aleksandra Babintseva, me shënim të artë në kategorinë -78 kg. Loriana e kaloi raundin e parë pa luftë, kurse në të dytin nuk i priu fati, pasi lufta që zgjati mbi gjashtë minuta po shkonte në favor të saj. Pavarësisht prej eliminimit, pjesëmarrja në Olimpiadë për Loriana Kukën është një përvojë e mirë, e cila do t'i shërbejë shumë për të ardhmen e ndritur. Ekipi i xhudos në këtë mënyrë i mbyll lojërat olimpikë

me një sukses të jashtëzakonshëm, pasi arriti të fitojë dy medalje të arta me Distria Krasniqin dhe Nora Gjakovën. Krenaria e sportit të Kosovës, Majlinda Kelmendi, nuk arriti të fitojë medalje ashtu sikurse Akil Gjakova. Trajneri Driton Kuka ka thënë se medaljet e arta shumë shpejt do të arrijnë në tokën shqiptare. "Medaljet olimpikë për popullin shqiptar së shpejti do të zbarkojnë në trojet shqiptare. Xhudistët e ekipit tonë i përfunduan garat në Lojëra Olimpikë! Dy medalje të arta! Ende po më duket si ëndërr e mirë. Pesë garues e dy të arta. Medaljet janë të krejt ekipit me protagonistë Disin e Norën. Ashtu siç ishte e arta e Majlindës. Ekipi që stërvitim jemi ne,

gëzohemi e qajmë së bashku në fitore e humbje, se aty qëndron forca jonë e madhe! Kemi në krye Agronin që çdo ditë duron tekat e mia të trajnerit, por kjo krejt është shpaguear. Dy olimpiada, tri 3 medalje të arta! Me dhjetëra medalje evropiane e botërore! Këta jemi ne!", ka thënë Kuka, i cili është shumë mirënjohës për të gjitha mesazhet e urimet që ka marrë. "Ata që kanë menduar që medalja e artë e Majlindës është e para dhe e fundit, janë mashtruar në llogari! S'po flas më shumë për sojin e juaj, se s'dua ta prish festën e madhe! E kam thanë edhe më herët: Me ujë, zjarr e xhudon e Kosovës s'ka lojë! Kosova mbi të gjitha", ka shtuar Kuka.

## SHKURT

### Shala mëson kundërshtarin në Lojërat Olimpikë

Egzon Shala e ka mësuar shortin për garat e mundjes në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Mundësi i Kosovës do të përballet në raundin e parë me Dzianis Khramiankou të Bjellorusisë, kategoria deri në 125 kg. Egzoni e ka vlerësuar tejet të pafat shortin. "Është shorti më i keq i mundshëm. Të gjithë kundërshtarët e grupit tim janë medalistë. Bjellorusi është fituesja e turneut kualifikues evropian për Tokio 2020", ka thënë Shala për Komitetin Olimpik të Kosovës. Ai garon më 5 gusht. Egzon Shala në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" është kualifikuar me normë, si i pesti në Kampionatin Botëror "Astana 2019".

### Zyba operohet me sukses

FC Prishtina ka njoftuar se mesfushori Qëndrim Zyba është operuar me sukses. Zyba ishte lënduar në ndeshjen ndaj Ferencvaroshit në Ligën e Kampionëve. Në njoftimin e klubit kampion të Kosovës nuk është specifikuar se kur do të rikthehet futbollisti Zyba. "Qëndrim Zyba, mesfushori ynë i talentuar, është operuar me sukses, operim ky i cili vjen pas lëndimit të pësuar në ndeshjen ndaj Ferencvaroshit në Ligën e Kampionëve. Operimi u realizua nga dr. Qërim Kida në Spitalin 'Royal Medical' të cilët i falënderojmë jashtëzakonisht shumë për kujdesin ndaj Qëndrimit dhe secilit futbollist të FC Prishtina. Rikthim të shpejtë, kampion", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.

### Fotis Takianos i prin Rahovecit edhe në kampionatin e ri

KB Rahoveci ka vendosur ta vazhdojë bashkëpunimin me trajnerin grek Fotis Takianos. Lajmi është bërë me dije nga faqja zyrtare e KB Rahovecit në "Facebook". "Siç e kemi thënë edhe në përmblyllje të edicionit, se kur ia dhamë lamtumirën, ai nuk kishte pranuar. Thellë-thellë brenda vetes dinte se do të bashkoheshim sërish. Ashtu edhe ndodhi. Klubi ka kënaqësinë të njoftojë për marrëveshjen me trajnerin Fotis Takianos. Në edicionin e ri ai do të bëjë më të mirën për ngjyrat 'bardhekaltër' nga 'Mizahir Isma', thuhet në njoftimin e "Vreshtarëve".

## Musa Hajdari synon të lërë gjurmë në Olimpiadë

**PRISHTINË, 29 KORRIK** - Atleti Musa Hajdari synon të lërë gjurmë në Lojëra Olimpikë. Atleti i Kosovës është një prej 11 garuesve që po e përfaqësojnë vendin tonë në "Tokio 2020". 33-vjeçari do ta ketë rastin e tij të shtunën, kur do të garojë në disiplinën vrapim 800 metra. Gara e tij do të fillojë në orën

02:00 pas mesnate me kohën lokale të Kosovës dhe do të mbahet në Stadiumin Olimpik të Tokios. Hajdari do të përpiqet të bëjë paraqitje sa më të mirë në këtë garë, ku konkurrenca është jashtëzakonisht e madhe. Për atletin e Roganës kjo është hera e dytë që merr pjesë në Olimpiadë pas asaj të

"Rio 2016". Hajdari është një nga pesë garuesit e Kosovës që po merr pjesë në "Tokio 2020" me ftesë. Ai ka mbërritur në Japoni disa ditë më parë, ku ka ushtruar nën urdhrat e trajnerit Zijadin Kryeziu. Hajdari është garuesi i parafundit i Kosovës që paraqitet në "Tokio 2020".



## KB Peja konfirmon pjesëmarrjen në Ligën Unike

PEJË, 29 KORRIK - KB Peja ka konfirmuar pjesëmarrjen në edicionin e ri të Ligës Unike. Klubi pejan ka konfirmuar pjesëmarrjen dhe nga ky klub janë shprehur të lumtur se do të jetë pjesë e Ligës, ku garojnë top-

klubet nga Kosova dhe Shqipëria. Peja edicionin e kaluar ishte finaliste e Ligës Unike, duke pësuar humbje në finale nga Golden Eagle Ylli. Peja ishte edhe finaliste në "play-off" të Superligës së Kosovës në

basketboll ku, po ashtu, kishte humbje nga Ylli. Risi në këtë edicion do të jetë edhe fillimi i garës në konkurrencën e femrave, me tri skuadra nga Kosova dhe tri nga Shqipëria, derisa shorti për të dyja

konkurrencat do të hidhet në muajin gusht. Edicioni i ri në Ligën Unike do të fillojë më 20/21 tetor, kurse para fillimit të garave do të organizohet Superkupa Mbarëkombëtare në të dyja konkurrencat.



## Maxhuni: Jam optimist për suksese

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kosova U18 po vazhdon përgatitjet për FIBA European Challengers që do të zhvillohet nga 3 deri më 8 gusht në Tiranë të Shqipërisë. Basketbollistët e rinj të Kosovës tashmë janë në fundin e përgatitjeve, kurse të dielën do të udhëtojnë drejt kryeqytetit shqiptar ku do të zhvillohet gara. Përzgjedhësi i Kosovës U18, Bekim Maxhuni, është shprehur i kënaqur me rrjedhën e stërvitjeve deri më tani. "Grumbullimet e para i kemi pasur para dy muajve. Deri më tani jam i kënaqur me atë se çfarë kanë dhënë basketbollistët në stërvitje. Jemi munduar që të përgatitemi sa më mirë. Atmosfera ka qenë shumë pozitive nga fillimi i përgatitjeve e deri më tani", ka thënë Maxhuni për faqen zyrtare të FBK-së. Kosova është në grup me Shqipërinë dhe Moldavinë. "Ne udhëtojmë për fitore. Duke marrë parasysh përgatitjet që i



kemi pasur, jam optimist. Do të mundohemi të shënojmë dy fitore në grup, më pas normalisht varet edhe nga fati e lëndimet e mundshme", ka shtuar Maxhuni. Sfidën e parë Kosova e ka ndaj Shqipërisë më 3 gusht, kurse pas dy ditësh përballlet me

Moldavinë. Dy kombëtalet e para kualifikohen tutje. Varësisht nga rezultatet në grup, më pas do të garohet për pozitat e tjera. Kosovës U18 në ditët e fundit i janë bashkuar edhe Dion Sheqiri dhe Albatrit Sylja që garuan me Kosovën U20 në Hungari.

## Khudisti iranian ia kushton Izraelit medaljen olimpikë

TOKIO, 29 KORRIK - Saeid Mollaei e fitoi medaljen e argjendtë në xhudo në Lojërat Olimpikë në "Tokio 2020" të martën dhe e përdori atë për ta nderuar armikun e atdheut të vet. Mollaei, i lindur dhe rritur në Iran, por që garon për Mongolinë, ia kushtoi medaljen e argjendtë Izraelit. Irani dhe Izraeli janë armiq që prej vitit 1985. Mollaei e fitoi medaljen e parë olimpikë në xhudo dy vjet pasi e braktisi atdheun e vet, Iranin. Ai u largua pasi, siç kishte thënë, trajneri i ekipit kombëtar iranian e kishte urdhëruar të humbë në gjysmëfinale të Kampionatit Botëror 2019, në mënyrë që të mos përballlej me khudistin izraelit Sagi Muki. Pasi e fitoi medaljen e argjendtë në Tokio, Mollaei ka thënë: "Faleminderit



Izraelit për energjinë e mirë! Këtë medalje ia kushtoi edhe Izraelit. Shpresoj se Izraeli është i lumtur me këtë fitore". "Todah", shtoi ai në gjuhën

hebraishte, që në shqip do të thotë: "Faleminderit". Izraeliti Muki e uroi Mollaein për fitimin e medaljes. Ata u bënë miq pas incidentit në vitin 2019.

### SHKURT

#### Qitësja shqiptare renditet e fundit në finalen e 25 metrave pistoletë precizion

Manuela Deliaj nuk ia del të kualifikohet as në finalen e 25 metrave pistoletë precizion. Qitësja shqiptare u rendit në vendin e 10 në baterinë e saj siç njofton KOKSH që e cilëson si paraqitje pozitive duke pasur parasysh dëmtimin që kishte në parakrahun e djathtë Deliaj. "Manuela Deliaj ka përfunduar garën e parë të 25m pistoletë precizion në qitje sportive, me rezultatin e 280 pikëve në total të grumbulluara. Kjo garë ishte një performancë e mirë duke pasur parasysh që Manuela ka një lëndim në parakrahun e djathtë. Gjithashtu, ju rikujtojmë se pjesa e dytë e garës, 25 m pistoletë shpejtësi (rapid) do të zhvillohet nesër në të njëjtën orë (ora 09:00 lokale). Suksese Manuela", thuhet në njoftimin e KOKSH-it.

#### Mbappe: Ëndërroj Ligën e Kampionëve me PSG-në

Sulmuesi i PSG-së, Kilyan Mbappe, ende nuk e ka rinovuar kontratën që i skadon në qershor të vitit 2022, por ka zbuluar se ëndrra e tij e madhe është që ta fitojë Ligën e Kampionëve me skuadrën franceze. "Ëndrra ime më e madhe do të ishte ta fitoja Ligën e Kampionëve me Paris Saint-Germain. Kjo do të ishte shumë mirë, por edhe të fitoja edhe një Kupë të Botës do të ishte e mrekullueshme", ka thënë Mbappe.

#### Dortmundi nuk lejon largimin e Halaandit

Erling Halaand do të qëndrojë te Borussia e Dortmundit të paktën edhe për një sezon tjetër. Drejtori ekzekutiv i klubit gjerman Hans Joachim Watzke ka qenë i prerë në lidhje me të ardhmen e supertalentit norvegjez. "Nuk dua të zgjatem shumë. Erling Halaand këtë sezon do të jetë lojtar i Borussia-s së Dortmundit", ka deklaruar ai. Chelsea kishte bërë një ofertë prej 175 milionë eurove, por klubi gjerman ka refuzuar ta shesë yllin e saj në këtë afat kalimtar.

#### Vidal: Dua t'i tregoj botës kush jam

Arthuro Vidal është përfolur shumë mbi një largim të mundshëm nga Interi këtë verë, por përmes një deklaratë për mediat italiane ai lë të kuptohet se do të vazhdojë me zikaltrit dhe këtë vit premtan se do të jetë më i rëndësishëm për ekipin. "Kam dëshirë të madhe për t'u rikthyer në fushë. Sezoni i shkuar nuk ishte i shkëlqyer për mua. Humba tre muajt e fundit për shkak të dëmtimit. Dua të ndihem mirë dhe t'i tregoj gjithë botës se kush jam. Fola me klubin. Kemi një marrëdhënie të mirë. Ai ka shumë besim tek unë. Këtë vit do të bëj më mirë. Kam folur me Inzaghin. Është trajner i nivelit të lartë. Ai e bën ekipin të ndihet mirë", ka thënë Vidal.

## 19-vjeçarja vendos rekord të ri në not

Në garën e stafetës 4 herë 200 metra stil i lirë në not Kina befasoi përfaqësueset e Shteteve të Bashkuara dhe Australinë duke merituar medaljen e artë. Në ndërresën e fundit 19-vjeçarja Li Bingjie preku murin me kohën e

përgjithshme 7' 40" 33, duke vendosur një rekord të ri botëror. Katie Ledecky e përshkoi itinerarin e saj për kohën fantastike 1' 53" 76, megjithatë si 24-vjeçarja e famshme nga Uashington D. C. ashtu edhe australianja Ariarne Titmus humbën

mundësinë për t'u shtuar sukseseve të tyre në këtë olimpiadë edhe një tjetër medalje të artë. Ky është i pari rekord botëror në garat e notit në Lojërat Olimpikë të Tokios dhe interesant është fakti që tri skuadrat medaliste ia dolën për ta ulur kohën e tyre poshtë

rekordit të vjetër, që mbahej nga Australia dhe ishte vendosur në botërorin e vitit 2019. Shtetet e Bashkuara e përfunduan garën 0,4" larg Kinës, ndërsa skuadra e Australisë u pozicionua e treta, me afërsisht 1" vonesë kundrejt vendit të parë.



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com), [info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)  
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **28.07.2021**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022**

**STUDIME BACHELOR**

- 1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar)
- 2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar)
- 3.MENAXHIMI I EMERGJENCAVE (BA) - (3 vjeçar)
- 4.JURIDIK / LLB - (4 vjeçar)

**STUDIME MASTER**

- 1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar)
- 2.MENAXHIMI I EMERGJENCAVE – MA-(2 vjeçar)

[www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com),  
[info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)

038/045- 500 878 : 029-230-555  
044/ 049/ 048- 500 – 878

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK**

**I.PROFESORA**

1. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
2. Gjashtë (6) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
3. Gjashtë (6) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
4. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
5. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin
6. Pesë (5) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin

**MENAXHMENT DHE EKONOMIKS - BA**  
**JURIDIK LLB**  
**MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - BA**  
**BANKA DHE FINANCA NË BIZNES - BA**  
**MENAXHMENT DHE FINANCA - MA**  
**MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - MA**

**II.ASISTENTA**

1. Tre (3) asistent për lëndë ekonomike,
2. Tre (3) asistent për lëndë juridike,
3. Tre (3) asistent për lëndë të emergjencave,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

**Për vendin e punës mësimdhënës**, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse.

**Për vendin e punës asistent**, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar studimet Master në lëmin përkatëse, preferohet të kenë të regjistruar studimet e doktoratës (PhD).

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet Master jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **30.7.2021 deri më 09.08.2021**.

Paraqitja e dokumenteve: Rr.Motrat Qiriazi 29, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: [info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com)

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com) ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
  
Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 26.07.2021 bënë shpallje publike:

**NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-21-004**

Kemi pranuar një ofertë nga Balkan Marble Trade sh.p.k.

Me kontratë shpërblehet Balkan Marble Trade sh.p.k, me ofertë 2,907.80 € me TVSH.

Kontrata është paraparë të nënshkruhet me datën 05.08.2021 ora 10:00

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku inustrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore**

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 2369/21 të datës 16.06.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomandë:**  
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmpb-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
[Suzana.goranci@rks-gov.net](mailto:Suzana.goranci@rks-gov.net)  
Telefon: + 381 38 200 32 553

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

 **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:


- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





 [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)


**Lume's Details**


Estetik & Depilim






 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- ▶ N.SH. "Laught Prishtina" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70914107 si dhe me nr. fis: 600907367.
- ▶ "Filma KS" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71213234 si dhe me nr fis: 601538880.
- ▶ Feraset Asllani, Berjahë Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.M.M.U. "Bajram Sadriu" Berjahë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULË

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues